



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

PROJEKT VENDIM

Nr. 2 datë 16.01.2025

**Rishqyrtim Vendimi Këshilli Bashkiak nr.95 dt.23.12.2024 mbi "Dhënien e ndihmës
financiare familjes së z.Gezim Osman Mahmuti që i është dëmtuar banesa si pasojë e zjarrit
të rënë me dt.26.10.2024 banorë i Bashkisë Vau-Dejës**

Bazueshmëria ligjore e vendimit të propozuar është:

Ligji Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar , Ligji Nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile", VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", Udhezimin Nr.3 dt.28.12.2016 "Për miratimin e kostos së ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave per vitin 2016, si dhe në shkresën Nr.373/1 dt.17.05.2016 të Prefekturës së Qarkut Shkodër "Në lidhje me çmimet e mobiljeve, orëndive dhe pajisjeve elektroshtëpiake të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve"si dhe pas shqyrtimit të projekt vendimit nr.4 dt.16.12.2024, paraqitur nga Sektori i Emergjencave Civile, ku propozohet dhënia e ndihmës financiare për shtetasin **Gëzim Osman Mahmuti** banorë i fshatit Kosmaç të Njësisë Administrative Bushat të Bashkisë Vau Dejës, Këshilli Bashkiak

V E N D O S I :

1. Miratimin e dhënies së ndihmës së menjëhershme financiare familjes së **z.Gëzim Osman Mahmuti** (4 anëtare në familje) me vlerën **80.000** (tetëdhjetëmije) lekë për dëmtimin plotësisht të banesës së tij nga zjarri.
2. Miratimin e proces verbalit të konstatimit të gjendjes dhe dokumentacionit të vlerësimit të dëmeve të hartuar nga grupi i punës me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë Nr.693 prot dt.12.11.2024 në vlerën totale **2.556.152** (dymilion e pesëqind e pesëdhjete e gjashtë mijë e njëqind e pesëdhjetë e dy) lekë për shtetasin **Gëzim Osman Mahmuti** banorë i fshatit Kosmaç të Njësisë Administrative Bushat të Bashkisë Vau Dejës.
3. Miratimin e dhënies së ndihmës financiare për shtetasin **Gëzim Osman Mahmuti** banorë i fshatit Kosmaç të Njësisë Administrative Bushat të Bashkisë Vau-Dejës me shumën **1.278.076** (Njëmilion e dyqind e shtatëdhjetë e tetëmije e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë në masën **50%** të vlerës totale të dëmit për të përballuar dëmet e shkaktuara në banesën e tij nga djegia e banesës me dt.26.10.2024.
4. **Efektet:** Krijon lehtësira për përballimin e situatës emergjente të banorit të dëmtuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

5. **Burimi i financimit** do të jetë fondi i planifikuar në programin "Emergjencat Civile" i cili është miratuar në Buxhetin e Bashkisë sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr 91 dt.21.12.2023 "Për miratimin e Buxhetit të vitit 2024

Konfirmoi bazen ligjore

Jakushë Shkollë

Konceptoi

Valjeta NIKAJ

Valjeta Nikaj

KRYETARI I BASHKISË

Kristian SHKRELI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV/KRYETARI

Aleksandra GJONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

Relacion

Objekti: "Ndërtese (banesë) 1 katëshe me ku jeton familja e z. Gëzim Osman Mahmuti"

Vendodhja: Kosmaç ,Nj.A, Bushat , Z.K 2236 , nr. pas 515/4, Bashkia Vau-Dejes

Bazuar në urdhin e punës të ngritur nga titullari i bashkisë Vau Dejës me nr.693 datë 12.11.2024, grupi i punës verifikoi gjendjen në banesën e z. Gëzim Osman Mahmuti. Banesa ndodhet në fshatin Kosmaç të Njësisë Administrative Bushat , në zonën kadastrale 2236, z. Gëzim Osman Mahmuti .

Lidhur me shkresën e konfirmimit të prefekturës nr.871/1 dt.06.01.2025 e protokolluar nga ana jonë me shkresën nr.77 prot dt.09.01.2025 ju sqarojmë si më poshtë :

Gjatë inspektimit në terren grupi i punës ka bërë një vlerësim të saktë ku kanë marrë pjesë grup teknik më inxhinierë, juristë dhe ekonomistë që kanë kryer matjet e banesës e cila ishte e shkatërruar totalisht ku është bërë dhe planimetria përkatëse. Gjithashtu bashkëngjitur po ju ridërgojmë dhe fotot të tjera shtesë për vertetimin e fakteve të përmendura në proces verbalin e konstatimit dhe në proces verbalin e vlerësimit.

Në vlerësimin e dëmëve të objektit, janë marrë parasysh çmimet e referencës nga Enti Kombëtar i Banesave, si dhe në përzgjedhja e zërave të punës është bërë në mënyrë të tillë, që banesa të rikthehet në gjendjen e saj fillestare, para se të përfshihej nga zjarri.

Theksojmë këtu se familja e cila perbehet nga 4 (kater) persona ka mbetur në qiell të hapur pa asnjë kusht për jetëse që nga data 26.10.2024 në një situatë jashtëzakonisht të vështirë ekonomike e sociale (kryefamiljari invalid, djali me paaftesi te pjeshme , bashkeshortja jetojnë tek stalla e bagëtive) .Vonesat në konfirmimin e vendimit të Këshillit vetëm sa ja vështirësojnë jetën familjes së Gëzim Osman Mahmuti. Familja që nga data 26.10.2024 është në pritje të mbështetjes nga ana e Bashkisë

Konceptoi
Valjeta Nikaj

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

N/KRYETARI I BASHKISË

Aleksandra GJONI



KRYETARI I BASHKISË
Kristian SHKRELI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER



Nr. 871/1 prot.

Shkodër, më 09.01.2025

Lënda: Mbi Vendimin nr. 95, datë 23.12.2024 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brëndshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neni 29, neni 54, shkronja "dh", neni 55, pika 3, neni 64, shkronja "c", të ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile", neni 30, shkronja "gj", neni 41, pika 2, të VKM nr. 329, datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës ekonomike shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", Kreu III, të shkresës së Këshillit Bashkiak Vau Dejës nr. 7627 prot., datë 27.12.2024 "Shkresë përcjellëse", shqyrtoi VKB Vau Dejës nr. 95, datë 23.12.2024 "Mbi dhënien e ndihme financiare familjes së z. Gëzim Osman Mahmuti që i është dëmtuar banesa si pasojë zjarrit, sipas Vërtetimit nr. 6754/1 të datës 14.11.2024 "Për rënie zjarri" të Drejtorisë së Shërbimit MZSH Vau Dejës", me ndihmë të menjëhershme me vlerë 80 000 lekë, me vlere totale të dëmeve ndërtimore dhe në orendi në masën 50% e vlerësimit ose 1 278 076 lekë, sipas shkronjës "ç", pika 3, Kreu III të VKM 329/2012, me burim financimi nga buxheti i Bashkisë Vau Dejës për vitin 2024.

Për sa trajtuar, Prefekti vëren se sipas fotove që shoqërojnë vendimin nuk rezulton që është kryear vlerësimi i duhur pasi ndërtesa nuk rezulton e shkatërruar totalisht për tu vlerësuar me kosto mesatare të ndërtimit, sipas paragrafit të II të shkronës "ç", pika 2, Kreu 2 të VKM 329/2012.

Për sa trajtuar, Prefekti nuk ju autorizon procedimin.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 95 datë 23.12-2024

“Mbi dhënien e ndihmës financiare familjes së z.Gëzim Osman Mahmuti që i është dëmtuar banesa si pasoje e zjarrit të rene me dt.26.10.2024 “

Bazueshmëria ligjore e vendimit të propozuar është:

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar,Ligjit Nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Udhëzimi nr.3 dt.28.12.2016 “Për miratimin e kostos së ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave , për vitin 2016, si dhe në shkresën Nr.373/1 dt.17.05.2016 të Prefekturës së Qarkut Shkodër “Në lidhje me çmimet e mobiljeve, orendive dhe pajisjeve elektroshtëpiake të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve” si dhe pas shqyrtimit te projekt vendimit Nr.4 dt.16.12.2024, paraqitur nga Sektori i Emergjencave Civile , ku propozohet dhënia e ndihmës financiare për shtetasin **Gëzim Osman Mahmuti** banorë i fshatit **Kosmaç** të Njesisë Administrative Bushat të Bashkisë Vau-Dejës, Këshilli Bashkiak:

V E N D O S I:

- 1.Miratimin** e dhënies së ndihmës së menjëhershme financiare familjes së **z.Gëzim Osman Mahmuti** (4 anëtare në familje) në vlerën **80.000** (tetëdhjetëmije) lekë për dëmtimin plotësisht të banesës së tij nga zjarri.
- 2.Miratimin** e proces verbalit të konstatimit të gjendjes dhe dokumentacionit të vlerësimit të dëmeve, të hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhrin e kryetarit te Bashkisë Nr.693 prot dt.12.11.2024 në vlerën totale 2.556.152 (dymilion e pesëqind e pesëdhjetë e gjashte mije e njëqind e pesëdhjete e dy) lekë për shtetasin **Gëzim Osman Mahmuti** banorë i fshatit Kosmaç të Njesisë Administrative Bushat të Bashkisë Vau-Dejës .
- 3.Miratimin** e dhënies së ndihmës financiare për shtetasin **Gëzim Osman Mahmuti** banorë i fshatit **Kosmaç** të Njesisë Administrative Bushat të Bashkisë Vau-Dejës me shumën **1.278.076** (njëmilion e dyqind e shtatëdhjetë e tetëmije e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë në masën **50%** të vlerës totale të dëmit për të përballuar dëmet e shkaktuara në banesën e tij nga djegia e saj me dt.26.10.2024.
- 4.Efektet:** Krijon lehtësira për përballimin e situatës emergjente të banorit të dëmtuar.
- 5.Burimi i financimit** do të jetë fondi i buxhetit të Bashkisë i miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.91 dt.21.12.2023 konfirmuar nga Prefektura Shkodër me shkresën 2/1 dt.09.01.2024.



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

6.Ngarkohen Drejtoria e Ekonomike (Sektori i Buxhetit dhe finances) për zbatimin e ketij vendimi.

7.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore"i ndryshuar).

KRYETAR

Ervis Shimaj

SEKRETAR

Ardian Çelepija



Miratuar me 21 vota

Vota Pro 21

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 27.10.2024

